



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

UDHËZIM

MBI

**RAPORTIMIN E SHITJEVE TË POLICAVE TË SIGURIMIT TË PUNONJËSVE TË
PUNËSUAR NË VEPRIMTARINË MINERARE NGA AKSIDENTET NË PUNË**

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 156, datë 24.07.2019

Neni 1

Të përgjithshme

Personat, që zotërojnë leje për të ushtruar veprimtari minerare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të kryejnë sigurimin e punonjësve të tyre nga aksidentet personale në punë, sipas një kontrate, pranë një shoqërie sigurimi.

Ky detyrim rrjedh nga VKM nr. 1109, datë 30.07.2008. “Për sigurimin e punonjësve, të punësuar në veprimtari minerare, nga aksidentet në punë”.

Kushtet standarde të kontratës së sigurimit, përfshirë tabelat e koeficienteve të përfitimit, sipas dëmtimeve shëndetësore, janë miratuar nga Bordi i Autoritetit sipas Vendimit nr. 92, datë 14.08.2008.

Ky Udhëzim hartohet bazuar në kërkesën e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2017”.

Neni 2

Objekti

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurës së identifikimit, raportimit të të dhënave të shitjes së policave të sigurimit të punonjësve nga aksidentet personale në fushën minerare, si dhe mënyra e funksionimit të këtij sistemi raportimi.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Ky udhëzim është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga shoqëritë e sigurimeve dhe agjentët/shoqëritë e agjentëve në sigurime, të licencuar nga Autoriteti në klasat që lidhen me këtë produkt sigurimi.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë udhëzim termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

- “Policë sigurimi”- është kontrata e sigurimit të punonjësve nga aksidentet personale në punë;
- “Përdorues i autorizuar”- është punonjësi i shoqërisë ose agjenti, i licencuar nga Autoriteti.

Neni 5

Shitja dhe raportimi i policave të sigurimit

1. Shoqëritë e sigurimit duhet të marrin të gjithë masat të zhvillojnë nga ana e tyre sistemin për ta përshtatur me shërbimet që do të ofrohen nga AMF, për të identifikuar dhe raportuar shitjen në kohë reale të çdo police minatori.
 - 1.1.Pavarësisht përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, shoqëritë e sigurimit apo agjentët mund të raportojnë shitjen, në një kohë të mëvonshme vetëm kur Sistemi AMF shfaq probleme madhore deri në mosfunksionimin e plotë të tij dhe kjo procedurë miratohet me shkrim nga drejtuesit ekzekutivë të Autoritetit sipas rastit.
2. Shoqëritë e sigurimit duhet të marrin të gjithë masat për të identifikuar dhe raportuar shitjen në kohë reale të çdo police të sigurimit të punonjësve nga aksidentet personale në punë.
3. Shoqëritë e sigurimit duhet të njoftojnë Autoritetin për të dhënat e identifikimit të personit të autorizuar. Për çdo ndryshim në lidhje me punonjësit e autorizuar që përdorin këtë sistem, shoqëria duhet të njoftojë me shkrim brenda 2 ditëve pune.

Neni 6

Specifikimet teknike për raportimin e policave

1. Subjektet e licencuar për të ushtruar veprimtari minerare, pajisen me një policë të sigurimit të detyrueshëm të minatorëve dhe në policë listohen të gjithë punonjësit, që

ushtrojnë aktivitet në kantierin e caktuar për llogari të këtij subjekti. Të dhënat që do të duhet të regjistrohen për këtë tip police përfshijnë të dhënat e kontratës:

Polica Kolektive:

- Lloji i produktit të sigurimit;
- Nr. i serisë së policës së sigurimit;
- Kontraktuesi (Policëmbajtësi);
- NIPT-i i Kontraktuesit;
- Vendndodhja e ushtrimit të aktivitetit/adresa;
- Dt. e shitjes;
- Dt. e Fillimit;
- Dt. e mbarimit;
- Primi;
- Monedha.

Certifikata Minatorëve:

- Emër i të siguruarit;
- Mbiemër i të siguruarit;
- ID e të siguruarit;
- Dt. e Fillimit të sigurimit;
- Dt. e mbarimit të sigurimit;
- Datëlindja;
- Pozicioni i punës në minierë;
- Shuma e sigurimit nga aksidentet personale.

2. Polica e sigurimit identifikohet nëpërmjet numrit unik të gjeneruar automatikisht nga Sistemi i Raportimit të Policave të Minatorëve dhe printohet në hapësirën përkatëse të policës. Shitja e policave nuk duhet të realizohet në rast se mungon numri unik i gjeneruar nga sistemi AMF.
3. Komunikimi i sistemeve informatike respektive të sistemit të raportimit të policave të Minatorëve, në funksion të dhënies së aksesit përdoruesve të autorizuar, duhet të realizohet nëpërmjet linjave të komunikimit (parësore dhe *back-up*). Për këtë arsye shoqëritë e sigurimit duhet të njoftojnë autoritetit për IP e tyre dhe për çdo ndryshim të mundshëm në të ardhmen.

Neni 7

Mënyra e funksionimit

1. Të dhënat e kërkesës për raportimin e policave të minatorëve nga shoqërinë e sigurimit vijnë në kohë reale në Sistemin e Raportimit të Policave të Minatorëve. Për çdo kërkesë programi gjeneron automatikisht një numër unik të rastësishëm, i cili printohet në policë në momentin e lëshimit. Ky numër i rastësishëm është unik dhe i

trajtës alfanumerike dhe shërben për të vërtetuar raportimin e policës në sistemin e Autoritet.

2. Polica e Minatorëve është policë kolektive, në të cilën vendoset nr. serisë, data e shitjes, periudha e vlefshmërisë, subjekti (të dhënat e të cilit kontrollohen me Regjistrin Kombëtar të Bizneseve), primi, statusi në të cilën ndodhet etj. Polica kolektive mund të përmbajë një ose më shumë punonjës të subjektit të licencuar për të ushtruar veprimtari minerare, me gjeneralitetet e punonjësit (të cilat kontrollohen me Regjistrin e Gjendjes Civile), pozicioni i punës në subjekt, shuma e sigurimit nga aksidentet personale etj., sipas nenit 6, pika 1 këtij udhëzimi.
3. Përdoruesit e autorizuar duhet të kryejnë raportimin e të dhënave të një police sigurimi në mënyrë të saktë sipas këtij udhëzimi.
4. Përveç raportimit të policave në kohë reale (neni 7, pika 1), gjithashtu duhet të reflektohen në kohë reale në Sistemin e Raportimit të Policave të Minatorëve edhe rastet si më poshtë së bashku me detajet përkatëse:
 - Anulimi i policës kolektive apo të një minatori të caktuar;
 - Lëshimi i dublikatave të policës kolektive apo të një minatori të caktuar;
 - Kthimi i policës të policës kolektive apo të një minatori të caktuar;
 - Shtimi i punonjësve në policën kolektive gjatë vlefshmërisë së saj.
5. Skema e detajuar dhe karakteristikat e procesit të identifikimit dhe raportimit të policave të minatorëve është paraqitur në Aneksin bashkëngjitur këtij udhëzimi.

Neni 8 **Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim hyn në fuqi më 01.09.2019.

Aneks

(Dokumentacioni Teknik)

Raportimi online në Sistemin e Raportimit të Policave të Minatorëve

➤ Kërkesa për shitjen e një police të re MINATORËSH:

Logjika për raportimin kësaj police do të jetë e njëjtë me TPL sipas dhe metodave të mëposhtme me disa ndryshime në pikat 2, 4 dhe 5:

1. Operacioni Fillestar i web service-it [doLogin](#)
2. **Operacioni i dytë i web service-it [doRequest](#)**
3. Operacioni i tretë i web service-it [doGetQKBDData](#)
4. **Operacioni i katërt i web service-it [doSendDataSM](#)**
5. **Operacioni i pestë i web service-it [doSavePoliceSM](#)**

Operacioni i dytë i web service-it [doRequest](#)

Ky operacion merr 4 parametra:

- a. Kodin e Shoqërisë së Sigurimit – variable i tipit string.
- b. Kodin e Agjencisë – variable i tipit string.
- c. Kodin e Agjentit – variable i tipit string.
- d. Kodin e llojit të policës – variable i tipit string.

Shembull:

```
final String doRequestResponse = client.doRequest(kodiShoqerise, kodiAgjensise, kodiAgjentit, kodiLlojit);
```

Për rasti e kërkesës për raportin e një police minatorësh, variabli i katërt **Kodi Llojit të Policës duhet të jetë i barabartë me 5.**

Pasi është bërë kërkesa nga përdoruesi dhe ajo ka rezultuar e vlefshme, web service-i kthen përgjigje për pranim të kërkesës, në të kundërt kthehet një mesazh gabimi që shpjegon arsyen e gabimit.

Operacioni i katërt i web service-it [doSendDataSM](#)

Shembull:

```
PoliceKolektiveMinatoreve data = new PoliceKolektiveMinatoreve();  
data.setDataFillimit("11.03.2019");  
data.setDataMbarimit("10.03.2020");  
data.setDataPageses("11.03.2019");  
data.setDataShitjes("11.03.2019");  
data.setDtRegjistrimiSubjektit("01.01.2018");  
data.setEmriSubjektit(qkbCompanyName);  
data.setKodiAgjensise(kodiAgjensise);  
data.setKodiAgjentit(kodiAgjentit);
```

```

data.setKodiLlojit(kodiLlojit);
data.setKodiPeriudhes(kodiPeriudhes);
data.setKodiShoqerise(kodiShoqerise);
data.setNipt(nipt);
data.setNrSerial(serialNum);
data.setNrShitjes("1");
data.setPrimi(new BigDecimal(1000));
data.setShenime(" ");
data.setTaksaPrimit(BigDecimal.ZERO);
data.setTotaliPageese(new BigDecimal(1000));
data.setTvsh(BigDecimal.ZERO);
data.setVendndodhjaSubjektit(qkbCompanyAddress);
ArrayList<PoliceMinatori> list = new ArrayList<PoliceMinatori>(2);
PoliceMinatori pm1 = new PoliceMinatori();
pm1.setDatelindja("01.01.1980");
pm1.setDtFillimi("11.03.2019");
pm1.setDtMbarimi("10.03.2020");
pm1.setEmer("Eraldo");
pm1.setMbiemer("Hasanaj");
pm1.setNid("I90401090F");
pm1.setNrSerial("111222001");
pm1.setPozicioni("Minator");
pm1.setShuma(new BigDecimal(500));
pm1.setStatusi("1");
PoliceMinatori pm2 = new PoliceMinatori();
pm2.setDatelindja("01.01.1985");
pm2.setDtFillimi("11.03.2019");
pm2.setDtMbarimi("10.03.2020");
pm2.setEmer("Elton");
pm2.setMbiemer("Lika");
pm2.setNid("J11225055L");
pm2.setNrSerial("111222002");
pm2.setPozicioni("Minator");
pm2.setShuma(new BigDecimal(500));
pm2.setStatusi("1");
list.add(pm1);
list.add(pm2);
data.setPolicatMinatoreve(list);

final String doSendDataSMResponse = client.doSendDataSM(data);

```

Per policen kolektive plotësohen fushat si më poshtë tek objekti i tipit *PoliceKolektiveMinatoreve*:

```

String nrSerial;
String nrShitjes;
String dataShitjes;
String kodiShoqerise;
String kodiAgjensise;
String kodiAgjentit;
String kodiLlojit;
String kodiPeriudhes;
String dataFillimit;

```

```
String dataMbarimit;  
String dataPageses;  
BigDecimal primi;  
BigDecimal tvsh;  
BigDecimal taksaPrimit;  
BigDecimal totaliPageese;  
String shenime;  
String nipt;  
String emriSubjektit;  
String dtRegjistrimiSubjektit;  
String vendndodhjaSubjektit;  
ArrayList<PoliceMinatori> policatMinatoreve;
```

Për policën individuale të minatorit plotësohen fushat si më poshtë tek objekti i tipit `PoliceMinatori` :

```
java.lang.String statusi;  
java.lang.String nrSerial;  
java.lang.String nid;  
java.lang.String emer;  
java.lang.String mbiemer;  
java.lang.String pozicioni;  
java.math.BigDecimal shuma;  
java.lang.String datelindja;  
java.lang.String dtMbarimi;  
java.lang.String dtFillimi;
```

Operacioni i pestë i web service-it `doSavePoliceSM`

Ky operacion nuk merr parametra por finalizon ruajtjen në regjistër të policave të postuara në hapin e katërt.

➤ **Anulimi i një police kolektive ekzistuese MINATORËSH:**

Logjika për anulimin e policave kolektive të minatorëve është e njëjtë me policat e tjera, sipas dhe metodave të mëposhtme:

1. Operacioni Fillestar i web service-it `doLogin`
2. Operacioni i dytë i web service-it `doCancelPoliceRequest`
3. Operacioni i tretë i web service-it `doCancelPolice`

Anullimi i police kolektive të minatorëve duhet të shoqërohet me anulimin e të gjithë policave individuale të minatorëve një për një.

➤ **Anullimi i një police individuale ekzistuese MINATORËSH:**

Logjika për anulimin e policave individuale të minatorëve është e njëjtë me policat e tjera,

sipas dhe metodave të mëposhtme, me ndryshimin e vetëm tek operacioni 2:

1. Operacioni Fillestar i web service-it [doLogin](#)
2. **Operacioni i dytë i web service-it [doCancelMinerIndividualPoliceRequest](#)**
3. Operacioni i tretë i web service-it [doCancelPolice](#)

Operacioni i dyte i web service-it [doCancelMinerIndividualPoliceRequest](#)

Ky operacion merr si parametër kodin (tipi string) e policës individuale të minatorit që do anulohet.

➤ **Krijimi i dublikatës të një police kolektive ekzistuese MINATORËSH:**

Logjika për krijimin e dublikatës të policave kolektive të minatorëve është e njëjtë me policat e tjera, sipas dhe metodave të mëposhtme:

1. Operacioni Fillestar i web service-it [doLogin](#)
2. Operacioni i dytë i web service-it [doDublicatePoliceRequest](#)
3. Operacioni i tretë i web-service-it [doSendDataForDublicate](#)
4. Operacioni i katërt i web service-it [doSaveDublicate](#)

➤ **Krijimi i dublikatës te një police individuale ekzistuese MINATORËSH:**

Logjika për krijimin e dublikatës të policave individuale të minatorëve është e njëjtë me policat e tjera, sipas dhe metodave të mëposhtme, me ndryshimin e vetëm tek operacioni 2 dhe 3:

1. Operacioni Fillestar i web service-it [doLogin](#)
2. **Operacioni i dytë i web service-it [doDublicateMinerIndividualPoliceRequest](#)**
3. **Operacioni i tretë i web-service-it [doSendDataForEmployee](#)**

Operacioni i dyte i web service-it [doDublicateMinerIndividualPoliceRequest](#)

Ky operacion merr si parameter kodin e policës së minatorit.

Operacioni i trete i web service-it [doSendDataForEmployee](#)

Ky operacion merr si parameter kodin e polices se minatorit si dhe një objekt të tipit PoliceMinatori me fushat si me poshte:

```
String nrSerial;  
String dtFillimi;  
String dtMbarimi;  
String statusi;  
String nid;  
String emer;
```



```
String mbiemer;  
String datelindja;  
String pozicioni;  
BigDecimal shuma;
```

➤ Shtimi i një police individuale MINATORËSH:

Logjika për shtimin e një police të re individuale minatori është si me poshtë:

1. Operacioni Fillestar i web service-it [doLogin](#)
2. Operacioni i dytë i web service-it [doAddIndividualMinerPolice](#)

Operacioni i dytë i web service-it [doAddIndividualMinerPolice](#)

Ky operacion merr si parametër kodin e policës kolektive të cilës i përket dhe një objekt të tipit `PoliceMinatori` me fushat si me poshtë, i cili mban detajet e individit që po sigurohet me këtë police:

```
String nrSerial;  
String dtFillimi;  
String dtMbarimi;  
String statusi;  
String nid;  
String emer;  
String mbiemer;  
String datelindja;  
String pozicioni;  
BigDecimal shuma;
```

➤ Kthimi një police kolektive ekzistuese MINATORËSH:

Logjika për kthimin e policave kolektive të minatorëve është e njëjtë me policat e tjera, sipas dhe metodave të mëposhtme me ndryshimin e vetëm tek operacioni 3:

1. Operacioni Fillestar i web service-it [doLogin](#)
2. Operacioni i dytë i web service-it [doReturnPoliceRequest](#)
3. Operacioni i tretë i web service-it [doReturnCollectiveMinerPolice](#)

Operacioni i tretë i web service-it [doReturnCollectiveMinerPolice](#)

Ky operacion merr si parametër kodin e policës kolektive të cilës i përket dhe vlerën e primit të kthyer.

➤ Kthimi një police individuale ekzistuese MINATORËSH:

Logjika për kthimin e policave individuale të minatorëve është e njëjtë me policat e tjera, sipas dhe metodave të mëposhtme, me ndryshimin e vetëm tek operacioni 3:

1. Operacioni Fillestar i web service-it [doLogin](#)
2. Operacioni i dytë i web service-it [doReturnPoliceRequest](#)
3. Operacioni i tretë i web service-it [doReturnCollectiveMinerPolice](#)

Operacioni i tretë i web service-it [doReturnCollectiveMinerPolice](#)

Ky operacion merr si parametër kodin e policës individuale të cilës i përket dhe vlerën e primit të kthyer.